

KËRKESË PADI

Tiranë, më/...../2015

PADITËS:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë: “Devis” shpk & “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk, i përfaqësuar me prokurë nga Shoqëria “Devis” SHPK, shoqëri tregtare e së drejtës shqiptare, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me Nr. Nuis K31420012M, me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, Pallati 22/1, Tiranë

I PADITUR:

1. **Komisioni i Prokurimit Publik**, me adresë: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 3, Tiranë
2. **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”**, me adresë: Rruga e Dibrës, Nr. 372, Tiranë

OBJEKTI:

1. Shfuqizimin e aktit administrativ Vendim Nr. 199/2015, datë 15/04/2015 i Komisionit të Prokurimit Publik për sa i përket:
 - a) Pranimit të ankesës së paraqitur nga Operatori Ekonomik “A.G.S” shpk për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Devis” shpk & “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk
 - b) Detyrimit të Autoritetit Kontraktor të anulojë vendimin e KVO për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Devis” shpk & “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk në procedurën e prokurimit me objekt: “Për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet “QSU – Nënë Tereza Tiranë”;
 - c) Anulimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor “QSU – Nënë Tereza Tiranë”.
2. Detyrimin e Autoritetit Kontraktor “Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, të shpallë fitues të procedurës së prokurimit Bashkimit të operatorëve ekonomikë “Devis” shpk & “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk në procedurën e prokurimit me objekt: “Për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet “QSU – Nënë Tereza Tiranë”
3. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ Vendim Nr. 199/2015, datë 15/04/2015 i Komisionit të Prokurimit Publik deri në përfundimin e gjykimit të çështjes nga Gjykata.

BAZA LIGJORE:

Neni 17/a, 28-31, 40/1/a,e e vijues të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
Nenet 1, 46, 53, 64/3 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar

Nenet 108, 109, 118 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë

DREJTUAR: GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË

TIRANË

I/e nderuar z/zj. Gjyqtar/e,

I. Lidhur me rrethanat e çështjes

Në datën 11.12.2014 është publikuar nga Autoriteti Kontraktor Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë procedura e prokurimit "Procedurë e hapur, mbi kufirin monetar" me objekt "Për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet QSU Nënë Tereza Tiranë", me fond limit 1.106.416.176,7050 lekë (pa TVSH).

Kjo procedurë prokurimi është zhvilluar më datë 16.2.2015 dhe në të kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë:

Operatori	Vlera e ofertës
1. BOE "Ballkan Laundry" shpk & "Serv Hotel" srl	486.970.572 lekë, skualifikuar nga KVO
2. "K.P.L" shpk	794.772.726 lekë, skualifikuar nga KVO
3. BOE "Devis" shpk & "Dimensione të reja" shpk 888.185.320 lekë, kualifikuar nga KVO "Univers servis" shpk & "A-K Company" shpk	
4. "Neproma Service" srl	888.185.320 lekë, kualifikuar nga KVO
5. BOE "Shpresa" shpk & "Servizi Sanitari Integrati"	998.442.808 lekë, kualifikuar nga KVO
6. "A.G.S" shpk	1 071.947.800lekë, kualifikuar nga KVO
7. "W.Center"	Nuk ka paraqitur oferte ekonomike.

Kundër këtij vendimi të KVO, pasi është ezauruar edhe ankimi në Autoritetin Kontraktor, janë paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, dy ankesa:

Ankesa e parë ka shkuar në këtë organ nga BOE "Devis" shpk & "Dimensione të reja" shpk & "Univers Servis" shpk & "A-K Company" shpk me anën e të cilës kërkohej skualifikimi i operatorit ekonomik "Neproma Service" srl për shkakun se:

Nuk plotëson pikën e) kapaciteti teknik ne Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, ku kerkohet "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) punonjës për secilin nga vitet 2012, 2013 dhe Janar – Nëntor 2014 të vërtetuar me Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për numrin e punonjësve të siguruar të shoqëruar edhe me listëpagesat (formularët E sig 025a).

Kjo shoqëri nuk plotëson kriterin e mësipërm pasi për një nga vitet, konkretisht vitin 2012, nuk ka 60 punonjës të punësuar, por vetëm 57.5 të tillë.

Lidhur me këtë ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik pasi është njohur me dokumentacionin përkatës, në përputhje me faktin dhe ligjin ka konstatuar se Operatori Ekonomik "Neproma Service" srl nuk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit të kërkuar në pikën "e" të shtojcës nr. 7 Kapaciteti teknik, dhe si rrjedhim në mbështetje të neneve 46 dhe 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, ka vendosur të pranojë ankesën e paditësit "Devis" shpk & "Dimensione të reja" shpk & "Univers Servis" shpk & "A-K Company" shpk dhe të skualifikojë operatorin ekonomik "Neproma Service" srl.

Ankesa e dytë ka shkuar në KPP nga Operatori Ekonomik "A.G.S" shpk, me anën e të cilës kërkohej:

1. Skualifikimi i BOE "Devis" shpk & "Dimensione të reja" shpk & "Univers Servis" shpk & "A-K Company" shpk
2. Skualifikimi i operatorit ekonomik "Neproma Service" srl
3. Skualifikimi i BOE "Shpresa" shpk & "Servizi Sanitari Integrati"

Lidhur me këtë ankesë, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur të pranojë ankesën e shoqërisë "A.G.S" shpk dhe të skualifikojë të tre operatorët që renditeshin përpara shoqërisë "A.G.S" shpk.

Në kushtet kur Komisioni ka skualifikuar edhe ofertën e ankuesit "A.G.S" shpk, duke qënë se asnjë nga ofertat nuk kualifikohej, KPP në vendimin e tij nr. 199/2015 datë 15.4.2015 ka urdhëruar Autoritetin Kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit për mungesë konkurrence.

Pikërisht ky vendim i Komisionit të Prokurimit Publik përbën aktin administrativ që kundërshtohet nga ne paditësit si akt i marrë në kundërshtim me ligjin dhe që cënon në mënyrë të padrejtë të drejtat dhe interesat tona të ligjshme.

II. Lidhur me themelin e çështjes

Sikundër parashtruam më sipër, pas ankesës së shoqërisë "A.G.S" shpk Komisioni i Prokurimit Publik me Vendimin Nr. 199/2015, datë 15.4.2015 vendosi të skualifikojë ofertën e paditësit BOE "Devis" shpk & "Dimensione të reja" shpk & "Univers Servis" shpk & "A-K Company" shpk duke urdhëruar Autoritetin Kontraktor të anulojë vendimin për kualifikimin e tij si dhe duke urdhëruar autoritetin të anulojë procedurën e prokurimit.

Ky vendim i KPP është një vendim i marrë në kundërshtim me ligjin dhe si i tillë ai duhet të shfuqizohet.

A. Skualifikimi i BOE (paditësit) është bërë mbështetur në arsyetimin e mëposhtëm të KPP:

1. Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "b" dhe gërma "c" të Dokumenteve Standarte te Tenderit

Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "b" dhe gërma "c" nga autoriteti kontraktor është kërkuar përkatësisht:

- a. *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001:2008 sipas konformitetit me standartet europiane;*
- b. *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit ISO 14001:2004 sipas konformitetit me standartet europiane.*

Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga BOE rezulton se operatori ekonomik "Devis" shpk ka paraqitur dokumentet:

- a. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit EN ISO 14001:2004, lëshuar në datën 18.08.2014 dhe skadencë në datën 17.08.2017
- b. Certifikatë EN ISO 9001:2008 lëshuar në datën 25.02.2014 dhe skadencë në datën 24.02.2017

Ndërsa operatorët e tjerë të BOE nuk ka paraqitur asnjë dokument lidhur me plotësimin e këtij kriteri.

Mbështetur në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, Kreu VII, pika 2, gërma "b" parashikohet se: *"Para dorëzimit të ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, në një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementët konkrete. Pas krijimit të bashkimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e grupit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi"*

Në kreun VII, pika 2, "Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë", gërma "c" paragrafi i parë i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se: *"Cdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje"*.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese"*.

Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: *"Autoriteti Kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*.

Pra, lidhur me arsyetimin e mësipërm të KPP, si konkluzion mund të thuhet se KPP e konsideron të papërmbushur kriterin e kërkuar nga autoriteti në: shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "b" dhe gërma "c", pasi sipas tij Certifikatat e cilësisë nuk duhet të ishin sjellë vetëm nga operatori përfaqësues i BOE por nga të gjithë operatorët pjesmarrës në BOE në përputhje me % e pjesmarrjes në këtë bashkim.

2. Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "a" të Dokumenteve Standarte të Tenderit:

Shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të marra së bashku, në një vlerë jo më të madhe se 35% e fondit limit...

- *Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/tyre nga autoriteti kontraktor;*
- *Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse dhe/ose faturat tatimore të shitjes...*

...nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga BOE rezulton se operatori ekonomik "Univers Servis" shpk ka paraqitur dokumentat: fatura tatimore shitje me shoqëri private dhe institucione publike. Rezulton se nuk është paraqitur asnjë kontratë e lidhur me kompanitë private (për faturat e paraqitura) dhe asnjë kontratë dhe vërtetim realizimi për faturat e lëshuara nga institucionet publike.

Pra lidhur me arsyetimin e mësipërm të KPP, si konkluzion mund të thuhet se KPP e konsideron të papërbushur kriterin e kërkuar nga autoriteti në shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "a", pasi sipas tij operatori "Univers Servis" shpk nuk ka paraqitur kontrate me subjektet private ose shtetërore.

B. Vendimi i KPP nr. 199/2015 për sa i përket arsyetimit të përmendur në pikën A më sipër është marrë në kundërshtim me faktet dhe ligjin sepse:

1. Arsyetimi i përdorur nga Komisioni i Prokurimit Publik në pikën II.A.1 përbën interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit

Në dokumentet e tenderit, shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "b" dhe gërma "c" nga autoriteti kontraktor është kërkuar përkatësisht:

- a. *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001:2008 sipas konformitetit me standartet europiane;*
- b. *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambientit ISO 14001:2004 sipas konformitetit me standartet europiane.*

Sipas KPP ky kriter duhet të përmbushet nga secili anëtar i grupit të operatorëve ekonomikë. Këtë përfundim KPP e arrin në zbatim të kreut VII, pika 2, "Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë", gërma "c" paragrafi i parë i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se:

"Cdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje".

Le të analizojmë dispozitën e mësipërme, dhe logjikisht arrijmë në konkluzionin se interpretimi i bërë nga KPP vjen në kundërshtim me dispozitën e mësipërme:

Pg. 1 thuhet: *"Cdo operator ekonomik duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit"*

Pg. 2 thuhet: “Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë grupi i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje”

Por çfarë quhet kërkesa ligjore, kërkesa ekonomike, financiare, profesionale dhe kërkesa teknike? Në cilën nga këto kërkesa bën pjesë certifikata e cilësisë ISO e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor?

Përgjigjen e saktë lidhur me këto pyetje na i jep vetëm ligji, e konkretisht neni 46 i Ligjit “Për prokurimin publik”, sipas të cilit:

“1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) **kualifikimi profesional:** çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) **aftësia teknike:** operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

c) **gjendja ekonomike e financiare:** operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

ç) **kapacitetet ligjore:** operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

Pra, Certifikatat ISO të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor nuk bëjnë pjesë as në:

Kapacitetet ligjore	– në këndvështrim të VKM duhet të plotësohen nga cdo anëtar i BOE
Kapacitetet ekonomike	– në këndvështrim të VKM duhet të plotësohen nga BOE në përputhje me % e pjesmarrjes në bashkim nga cdo operator ekonomik
Kapacitetet financiare	- në këndvështrim të VKM duhet të plotësohen nga BOE në përputhje me % e pjesmarrjes në bashkim nga cdo operator ekonomik

- Kapacitetet profesionale - në këndvështrim të VKM duhet të plotësohen nga BOE në përputhje me % e pjesmarrjes në bashkim nga cdo operator ekonomik
- Kapacitetet teknike - në këndvështrim të VKM duhet të plotësohen nga BOE në përputhje me % e pjesmarrjes në bashkim nga cdo operator ekonomik

Për të cilësuar se ky kriter nuk bën pjesë në mënyrë direkte tek asnjë nga grupet e mësipërme, vetë ligjvënësi, nëpërmjet përdorimit të një teknike legjislativë ndarëse, në po të njëjtin nen (nenin 46), në paragrafin e 1 të së cilit jep përkufizimin e secilit nga kapacitetet/kriteret, ka sanksionuar edhe një paragraf 2 sipas të cilit:

“Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.”

Pra pikërisht këto lloj certifikatash, të lëshuara nga organe të pavarura mund të kërkojnë në raste të caktuara nga Autoritetet Kontraktore, por pa u interpretuar si pjesë përbërëse direkte e ndonjë nga kriteret/kapacitetet të përcaktuara në një paragraf më sipër të po të njëjtit nen.

Në të njëjtat kushte është edhe situata faktike lidhur me BOE “Devis” shpk & “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk.

Ky Bashkim Operatorësh ekonomikë i ka përmbushur të gjitha kriteret/kapacitetet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Kapaciteti ligjor është përmbushur sipas ligjit dhe VKM nga të gjithë anëtarët e BOE.

Kapaciteti ekonomik, financiar, profesional dhe teknik është përmbushur me sukses nga i gjithë Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë i marrë së bashku, në përputhje me përqindjen e pjesmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshjen përkatëse.

Ndërsa, kriteri i përcaktuar në shtojcën 7, gërma “b” dhe gërma “c” nga autoriteti kontraktor është plotësuar për të gjithë BOE ashtu sikundër pranon edhe KPP në arsyetimin e saj nga Operatori Ekonomik Shoqëria “Devis” shpk.

Theksojmë se: Plotësimi i këtij kriteri nga i gjithë Bashkimi i marrë së bashku është i mjaftueshëm në kuptim të kërkesave të Ligjit “Për prokurimin publik” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”

Theksojmë se: Vetë Autoriteti Kontraktor që ka hartuar Dokumentet Standarte të Tenderit dhe rrjedhimisht edhe kërkesat kualifikuese të operatorëve ofertues, nuk ka dashur që plotësimi i këtij kriteri, në rastin e BOE, të bëhej nga secili prej operatorëve anëtarë në BOE. Nëse ky do të ishte qëllimi i vërtetë i Autoritetit Kontraktor, atëherë:

Së pari, Autoriteti do të kishte cilësuar në DST, Shtojca 7, se ky kriter në rastin e BOE duhet të plotësohet nga secili operator;

Së dyti, edhe nëse KPP “interpretonte” se Autoriteti e ka “nënkuptuar” këtë fakt, ky interpretim bie poshtë, sepse vetë Autoriteti Kontraktor, nëse do të kishte këtë qëllim, do të kishte konsideruar të paplotësuar këtë kriter që në vlerësimin e ofertës në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Theksojmë se: Interpretimi i KPP, sipas të cilit përmbushja e kriterit, pra paraqitja e Certifikatave ISO duhet të plotësohet nga secili operator në përputhje me % e pjesmarrjes në Bashkim e Operatorëve Ekonomikë, nuk qëndron edhe nga ana logjike. Ky kriter plotësohet me paraqitjen e një dokumenti Certifikatës ISO. Rrjedhimisht, në vijim të logjikës së KPP:

Operatori "Devis" shpk	duhet të paraqiste 23% të Certifikatës ISO
Operatori "Dimensione të reja" shpk	duhet të paraqiste 40% të Certifikatës ISO
Operatori "Univers servis" shpk	duhet të paraqiste 11% të Certifikatës ISO
Operatori "A-K Company" shpk	duhet të paraqiste 26% të Certifikatës ISO.

Po a mund të realizohet praktikisht një gjë e tillë??? Kjo gjë jo vetëm është e perealizueshme sepse një Certifikatë nuk mund të ndahet në pjesë, por edhe nëse do interpretohet duke e zgjeruar kriterin, pra duke kërkuar pasjen e Certifikatës nga cdo anëtar i BOE, kjo do të përbente katërciprisht një kriter diskriminues, të paligjshëm dhe rrjedhimisht të pavlefshëm. Një interpretim i tillë është në kundërshtim edhe me frymën e ligjit, i cili nëse do të kishte mbajtur një standart të tillë atëherë nuk do të kishte parashikuar fare pjesmarrjen e shoqërive në procedura prokurimi nëpërmjet bashkimeve të përkohshme.

Theksojmë se: Është tërësisht logjike dhe e ligjshme që kriteri në fjalë të plotësohet nga BOE në tërësi. Madje për të shkuar më tej, ky kriter në emër të BOE, plotësohet nga operatori i përfaqësuar me prokurë shoqëria "Devis" shpk.

Sic përcaktohet edhe në aktmarrëveshjen përkatëse të operatorëve, nën drejtimin e shoqërisë "Devis" shpk do të kryhej shërbimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, cka tregon që qënia e shoqërisë "Devis" shpk e pajisur me *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë ISO 9001:2008 sipas konformitetit me standartet europiane*; do të sillte një standart të shtuar edhe për burimet njerëzore dhe mjetet e shoqërive të drejtuara prej saj.

Sic përcaktohet edhe në aktmarrëveshjen përkatëse të operatorëve, nën drejtimin e shoqërisë "Devis" shpk dhe në ambjentet e saj do të kryhej shërbimi i kërkuar nga Autoriteti Kontraktor, cka tregon që qënia e shoqërisë "Devis" shpk e pajisur me *Certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të ambjentit ISO 14001:2004 sipas konformitetit me standartet europiane*; përbën garanci absolute që shërbimi i kryer nga i gjithë BOE i marrë së bashku do të ishte në përputhje me standartet europiane për cilësinë e menaxhimit të ambjentit ku kryhet shërbimi.

Si përfundim, theksojmë se:

Arsyetimi i KPP dhe vendimi për të skualifikuar BOE "Devis" shpk & "Dimensione të reja" shpk & "Univers Servis" shpk & "A-K Company" shpk për shkak se nuk plotëson kriterin e përcaktuar në shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "b dhe c" të Dokumenteve Standarte të Tenderit është jo vetëm në interpretim të gabuar të faktit dhe ligjit, por vjen në kundërshtim me:

Nenin 1, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe me Dispozitat e Kreut VII, pika 2 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Nga ana tjetër, sipas nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin përbën një akt të pavlefshëm. Në këtë kuptim kërkojmë nga Gjykata që në përputhje me cka kemi parashtruar më sipër, në përputhje me nenin 118 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në përputhje me nenin 40/1/a të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” të shfuqizojë aktin administrativ në pjesën e pavlefshme të përmendur më sipër.

2. Arsyetimi i përdorur nga Komisioni i Prokurimit Publik në pikën II.A.2 përbën interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit

Në shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma “a” të Dokumenteve Standarte të Tenderit kërkohet përmbushja e kriterit të poshtëshënuar:

“Shërbime të mëparshme të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit të marra së bashku, në një vlerë jo më të madhe se 35% e fondit limit...”

- *Për kontratat e realizuara me institucione publike duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse të shoqëruar me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/tyre nga autoriteti kontraktor;*
- *Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse dhe/ose faturat tatimore të shitjes...*

Pra lidhur me këtë kriter KPP, ndryshe nga Autoriteti Kontraktor, e konsideron të papërmbushur kriterin e kërkuar nga autoriteti në shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma “a”, pasi sipas tij operatori “Univers Servis” shpk nuk ka paraqitur kontrate me subjektet private ose shtetërore.

Por nga ana tjetër KPP në vendimin e saj konfirmon se nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga BOE rezulton se operatori ekonomik “Univers Servis” shpk ka paraqitur dokumentat: fatura tatimore shitje me shoqëri private dhe institucione publike. Rezulton se nuk është paraqitur asnjë kontratë e lidhur me kompanitë private (për faturat e paraqitura) dhe asnjë kontratë dhe vërtetim realizimi për faturat e lëshuara nga institucionet publike.

Theksojmë se: Autoriteti Kontraktor, për përmbushjen e kriterit të mësipërm ka kërkuar qartësisht se: Për kontratat e realizuara me subjekte private duhet të paraqesë kontratën/kontratat përkatëse dhe/ose faturat tatimore të shitjes...

Pra për kontratat e realizuara me subjekte private, mjafton të paraqitet ose kontrata përkatëse ose fatura tatimore e shitjes.

Theksojmë se: Për përmbushjen e këtij kriteri në përputhje me % e pjesëmarrjes së saj në BOE, shoqëria “Univers Servis” shpk ka paraqitur një sërë faturash tatimore shitje me subjekte private, vlera e përgjithshme e të cilave e realizon me sukses kriterin e kërkuar nga Autoriteti, sipas mënyrës së kërkuar nga ligji dhe vendimi i këshillit të ministrave.

Theksojmë se: Komisioni i Prokurimit Publik ka përdorur një arsyetim të paqartë dhe të pasaktë. Ky organ ka bërë një lexim të njëanshëm të fakteve, kriterit të kërkuar dhe dokumenteve të paraqitura për plotësimin e këtij kriteri.

Si përfundim, theksojmë se:

Arsyetimi i KPP dhe vendimi për të skualifikuar BOE “Devis” shpk & “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk për shkak se nuk plotëson kriterin e

përcaktuar në shtojca 7, kapaciteti teknik, gërma "a" të Dokumenteve Standarte të Tenderit është jo vetëm në interpretim të gabuar të faktit dhe ligjit, por vjen në kundërshtim me:

Nenin 1, 46, 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe me Dispozitat e Kreut VII, pika 2 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Nga ana tjetër, sipas nenit 118 të Kodit të Procedurave Administrative një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin përbën një akt të pavlefshëm. Në këtë kuptim kërkojmë nga Gjykata që në përputhje me cka kemi parashtruar më sipër, në përputhje me nenin 118 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në përputhje me nenin 40/1/a të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" të shfuqizojë aktin administrativ në pjesën e pavlefshme të përmendur më sipër.

III. LIDHUR ME KËRKESËN PËR SIGURIMIN E PADISË

Ligji i aplikueshëm:

Ligji nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative":

Neni 28

"Sigurimi i padisë

1. Me paraqitjen e padisë, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ."

Neni 29

"Kushtet për sigurimin e padisë

Gjykata vendos sigurimin e padisë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin;*
- b) nuk cenohet rëndë interesi publik;*
- c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë.*

Neni 30

Llojet e masave për sigurimin e padisë

Sigurimi i padisë bëhet nëpërmjet:

- a) pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ;*

Lidhur me sa më sipër, pretendojmë se plotësohen të gjitha kushtet e kërkuara nga ligji për marrjen e masave për sigurimin e padisë.

1. Ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkaktimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin

Së pari, në rast se nuk do të merren masa për sigurimin e padisë, atëherë, Autoriteti Kontraktor në përmbushje të detyrimeve të tij që rrjedhin nga zbatimi i Vendimit Nr. 199/2015 të Komisionit të Prokurimit Publik, brenda dhjetë ditësh nga marrja dijeni:

- 1. Do të anullojë vendimin e KVO për kualifikimin e BOE “Devis” shpk & “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk**
- 2. Do të anullojë procedurën e prokurimit**
- 3. Do të ndërmarrë hapa për zhvillimin e një procedure tjetër prokurimi me të njëjtin objekt**

Përmbushja e këtyre veprimeve nga Autoriteti Kontraktor është tërësisht e provueshme jo vetëm me prova shkresore që përbëjnë provë të plotë, konkretisht Pjesa urdhëruese e vendimit nr. 199/2015 të Komisionit të Prokurimit Publik, por edhe me sanksionimet përkatëse për zbatimin e vendimeve të KPP në ligjin për prokurimin publik dhe VKM përkatëse.

Së dyti, në rast se do të ndërmerren të tilla vendime nga Autoriteti Kontraktor, **cënohen rëndë interesat e paditësit**. Theksojmë se vetëm në formën e dëmit të pësuar (shpenzime për marrjen pjesë në tender) paditësi ka shpenzuar mbi 5.000.000 (pesë milion) lekë, **të provuara këto edhe me prova shkresore**. Theksojmë se dëmi në formën e fitimit të munguar për shkak të skualifikimit në mënyrë të padrejtë dhe diskriminuese do të ishte i konsiderueshëm, **cka provohet edhe me prova shkresore**.

Pra, në rast se do të ndërmerren të tilla vendime nga Autoriteti Kontraktor, shkaktimi të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin nuk do të ishte më thjesht një mundësi, por do të ishte një realitet i pakthyeshëm.

2. Nuk çënohet rëndë interesi publik

Lidhur me plotësimin e këtij kushti, i bëjmë me dije Gjykatës se nga marrja e masave për sigurimin e padisë në rastin konkret, interesi publik jo vetëm që nuk çënohet (rëndë ose jorëndë) por **përkundrazi marrja e këtyre masave i shërben tërësisht mbrojtjes së interesit publik**.

Në rast se nuk do të merret masa për sigurimin e padisë, Autoriteti Kontraktor do të ekzekutojë detyrimet që rrjedhin nga Akti Administrativ i kundërshtuar. Nëse do të përmbushen këto detyrime, do të nisë nga e para procedura e prokurimit. Nisja nga e para e procedurës së prokurimit passjell nevojën për mbulim me shërbim të Autoritetit Kontraktor. Për të siguruar shërbimin, autoriteti do të kryejë prokurime me negociim për shkaqe emergjente, cka passjell një faturë financiare të lartë dhe që përbën shpërdorim të financave të institucionit e rrjedhimisht edhe të taksave të qytetarëve. Nga ana tjetër një shërbim i ofruar për një kohë të shkurtër do të sillte ulje të cilësisë së shërbimit.

Jo vetëm kaq, por në përfundim të procesit do të ishim përballë një situatë juridike të pakthyeshme: Autoriteti mund të arrijë në përfundim të procedurës së re të prokurimit, dhe ndërkohë që një shoqëri tjetër përgatitet të lidhë kontratën me autoritetin kontraktor, ky i fundit

përballet ose me detyrimin që të lidhë kontratën me BOE paditës në këtë padi dhe të shpërblejë dëmin që i sjell shoqërisë fituese “në të ardhmen”, ose me detyrimin që të lidhë kontratën me shoqërinë fituese “në të ardhmen” dhe të shpërblejë dëmin që ka pësuar BOE paditës.

3.Sa i përket llojit të masës që i shërben më së miri interesit të paditësit, interesit të autoritetit kontraktor, interesit publik dhe së drejtës, në përputhje me nenin 30/a të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” kërkojmë:

Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke pezulluar zbatimin e aktit administrativ Vendim Nr. 199/2015, datë 15/04/2015 i Komisionit të Prokurimit Publik deri në përfundimin e gjyimit të çështjes nga Gjykata.

IV. PËRFUNDIMISHT

Për gjithcka kemi parashtruar në këtë kërkesë padi, bazuar në arsyetimet juridike dhe provat që do të paraqesim në seancën gjyqësore, kërkojmë nga Gjykata që në përfundim të gjyimit të kësaj çështje, në përputhje me faktet, provat dhe ligjin të vendosë:

Pranimin e padisë sipas objektit.

Në emër të BOE

**“Devis” shpk
& “Dimensione të reja” shpk & “Univers Servis” shpk & “A-K Company” shpk**

“Devis” shpk

Administratori